

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për profilin mësimor

MBROJTJE E MJEDISIT PYJOR

Niveli III

(Në drejtimin mësimor PYJE)

Kodi: S4-III-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, të drejtimit mësimor “Pyje”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III .
- III. Plani mësimor për profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli i III, të drejtimit “Pyje”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, të drejtimit “Pyje”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit pyjor.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor” niveli III, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Pyje”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale në mbrojtjen e mjedisit pyjor.
- Të kryejë matje me instrumenta topografik dhe llogaritje të sipërfaqeve, përcaktim koordinatash, etj
- Të masë dhe të përcaktojë vëllimin e drurit në këmbë duke përdorur me saktësi pajisjet e mjetet matëse të lartësisë dhe diametrit.
- Të piketojë dhe të ndërtojë prita dhe vepra te tjera hidroteknike që përdoren në sistemimin e përrenjëve, prroskave, etj.
- Të zbatojë parimet e mbarështimit në pyjet dhe kullotat duke siguruar nje qëndrueshmëri të tyre, duke synuar në mbrojtje, të të gjitha vlerave të ekosistemit .
- Të trajtojë pyjet me funksione të vecanta, nëpërmjet metodave silvikulturale.
- Të kryejë pyllëzime në tokat e zhveshura dhe të marrë masa per mbrojtjen e tokës nga gërryerjet.
- Të kryejë shërbime dhe punime në kullota për përmirësim dhe mbrojtje të tyre
- Të inventarizojë dhe të përcaktojë masat per mbrojtjen e faunës dhe shtimin e tyre që ndodhen në zonën pyjore.
- Të mbrojnë pyjet/kullotat nga zjarret dhe dëmtuesit.
- Të përdorë dhe të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të zbatojë rregullat e sigurit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III,

e pajis nxënësin me çertifikatën e teknikut të mbrojtjes së mjedisit pyjor. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit të punësohet në shërbimin pyjor bashkiak, në strukturat e zonave të mbrojtura apo te skuadrave të MNZ. Pas një përvoje pune e trajnimeve të vazhdueshme, ai mund të krijojë një sipërmarrje të vetën duke punësuar edhe individë të tjerë në veprimtarinë e mbrojtjes së mjedisit pyjor.

Me përfundimin e suksesshëm të këtij niveli, nxënësi fiton njëkohësisht edhe diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare si dhe të arsimit pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III (2018-19).

Plani mësimor për profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III (2018-19)				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimorë	Orët javorë/vjetorë	
			Klasa 12	Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	10/11 (360/ 396)	14/16 (448/ 512)
1		Gjuhë shqipe (dhe Letërsi)	1	2
2		Letërsi	1	-
3		Gjuhë e huaj	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(2)
5		Histori	1	-
6		Gjeografi	1	2
7		Matematikë	2	2
8		Biologji	-	1
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Histori arti	-	2
11		Edukim fizik, sporte, shëndet	1	-
12		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji)	-	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (324)	10 (320)
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	-	1
3	L-07-453-17	Biodiversiteti	1	-
4	L-25-454-17	Ekologji pyjore	2	-
5	L-25-455-17	Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve	2	-
6	L-25-456-17	Mbarështrim pyjesh dhe kullotë pyjore	2	1
7	L-25-457-17	Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës pyjore	-	2
8	L-25-234-11	Mbrojtje natyre dhe planifikim territori	-	1
9	L-25-458-17	Energjia dhe mjedisi pyjor	-	1
10	L-25-236-11	Ligjshmëri mbi mjedisin	-	1
11	L-25-459-17	Ekosistemi pyjor		1
C.		Module të detyruara të praktikës profesionale	9	6

		(Gjithsej)	(324)	(192)
1	M-25-1376-17	Punime me instrumenta topografik	36	-
2	M-25-1377-17	Trajtimi i pyjeve fletorë dhe halorë	36	-
3	M-25-1378-17	Mbrojtje e tokës nga gërryerjet	72	-
4	M-25-1379-17	Punime në mbarështimin e pyjeve dhe kullotave	36	-
5	M-25-1380-17	Mbrojtje e pyjeve dhe kullotave nga zjarret	36	-
6	M-25-1381-17	Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në fidanishtet dhe masivet pyjore	36	-
7	M-25-1382-17	Pyllëzimet me farë dhe fidana	36	-
8	M-25-1383-17	Transporti i brendshëm pyjor dhe ndikimet në mjedis	36	
9	M-25-838-12	Punime përgatitore në rrugët pyjore		48
10	M-25-1384-17	Llogaritje ekonomike për aktivitete pyjore		30
11	M-25-837-12	Ruajtja dhe ekonomizimi i materialit drusor		48
12	M-25-1385-17	Përmirësimi e mbrojtja e bimëve mjeksore natyrore		33
13	M-25-1386-17	Inventarizimi dhe mbrojtja e faunës		33
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	2 (72)	-
1	M-25-659-11	Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme	36	-
2	M-25-1387-17	Shërbime për përmirësimin dhe mbrojtjen e kullotave	36	-
3	M-25-1388-17	Punime në inventarizimin e pyjeve	36	-
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1080/1116)	30/32 (960/1024)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Mbrojtje e mjedisit pyjor”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimeve të maturës shtetërore profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE)
- b) Provimit të praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit njohurive nga lëndët teorike, të përgjithëshme dhe profesionale, si dhe të kompetencave profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të mbrojtjes së mjedisit pyjor. Në përfundim, nxënësve u jepet diploma e maturës shtetërore si dhe certifikata e përgatitjes profesionale, në të cilat evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike të përgjithëshme dhe profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, si dhe rezultatet e provimeve përfundimtare.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës shtetërore profesionale si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional në nivelin e teknikut/menaxherit në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provimeve përfundimtare të Nivelit III.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 12 – 72 orë dhe kl. 13 - 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes” në kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 72 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për Marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë
Tema 12	<i>Detjrë praktike</i> për llogaritjet ekonomike në veprimtarinë profesionale	4 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit

- Të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- Të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- Të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- Të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- Të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- Të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- Të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- Të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- Të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- Të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë**

Tema 1	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
Tema 3	Aftësitë menaxheriale	6 orë
Tema 4	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
Tema 5	Menaxhimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 6	Menaxhimi i informacionit	6 orë
Tema 7	Menaxhimi marketing	5 orë
Tema 8	Menaxhimi financiar	9 orë
Tema 9	Zhvillimi i një plani biznesi	7 orë
Tema 10	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
Tema 11	Kuadri ligjor dhe taksat	4 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 32 orë

• **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm

- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13-32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	<u>Veprimtari praktike</u> për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Biodiversiteti” (L-07-453-17), kl. 12 – 36 orë

• **Synimet e lëndës “Biodiversiteti”, kl 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Biodiversiteti”, klasa12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë diversitetin e specieve në mjedisin pyjor;
- Të shpjegojnë lidhjen midis diversitetit të specieve dhe qëndrueshmërisë së ekosistemit pyjor;
- Të listojnë speciet e rrezikuara sipas statusit të tyre;
- Të përshkruajnë rrjetin ekologjik të zonave të mbrojtura dhe kategoritë sipas klasifikimeve ndërkombëtare;
- Të analizojnë faktorët që ndikojnë në vlerat e biodiversitetit të një mjedisi pyjor;
- Të shpjegojnë të dhënat kryesore (tabela, grafikë) për biodiversitetin në një rast studimi të një mjedisi pyjor;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Biodiversiteti”, kl.12 - 36 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithme për biodiveritetin	2 orë
Tema 2	Vlerat e biodiversitetit (vlerat e konsumueshme dhe jo të konsumueshme)	6 orë
Tema 3	Rreziqet e biodiversitetit në mjedisin pyjor dhe shkaqet e zhdukjes së specieve të florës dhe faunës.	6 orë
Tema 4	Speciet e rrezikuara në Shqipëri. Kategorite e rrezikut sipas standarteve ndërkombëtare.	8 orë
Tema 5	Ruajtja e biodiversitetit.	4 orë
Tema 6	Biodiversiteti dhe ndryshimet klimatike	6 orë
Tema 7	<u>Veprimtari praktike</u> për biodiversitetin në një mjedis pyjor	4 orë

4. Lënda “Ekologji pyjore” (L-25-454-17), kl, 12 -72 orë

- Synimet e lëndës “Ekologji pyjore” kl. 12 - 72 orë

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Ekologji pyjore” kl 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ndikimin e faktorit klimatik në jetën e grumbullit pyjor
- Të shpjegojnë ndikimin e pyllit mbi klimën
- Të përcaktojnë llojet e humusit dhe karakteristikat e tyre
- Të përcaktojnë mënyrat e ripërtëritjes së pyllit
- Të dallojnë etapat nga fazat e zhvillimit të pyllit
- Të përcaktojnë zonat fitoklimatike
- Të dallojnë format e mbarështimit të pyjeve
- Të përcaktojnë trajtimet në cungjishte
- Të përcaktojnë mënyrat e shndërrimit të pyjeve
- Të zbatojnë trajtime në pyje

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ekologji pyjore”, kl 12- 72 orë

Tema 1	Rëndësia e faktorëve ekologjik në jetën dhe zhvillimin e pyjeve dhe kullotave.	1 orë
Tema 2	Ndikimi i faktorëve klimatik në jetën e grumbullit pyjor, fazat e zhvillimit të pyllit, si dhe mënyrat e ripërtëritjes së pyllit	9 orë
Tema 3	Raportet ndërmjet pyllit dhe tokës, njohja e horizonteve të tokës dhe roli i tyre në jetën dhe zhvillimin e bimësisë pyjore.	7 orë
Tema 4	Shpërndarja e bimësisë pyjore dhe kullosore në zonalitet vertikal dhe horizontal	5 orë
Tema 5	Tipet e vegjetacionit pyjor sipas zonave fitoklimatike	3 orë
Tema 6	Regjimet kryesore të pyjeve; trungjishteve, cungjishteve dhe shkurreve	10 orë
Tema 7	Gjendja reale e pyjeve të vendit tonë, grumbujt e degraduar shkaqet kryesore	7 orë
Tema 8	Formacionet e pyjeve malore në sipërfaqe të pjerrëta, si dhe masat e veçanta për zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre;	5 orë
Tema 9	Masat kryesore teknike dhe organizative për përmirësim të gjendjes në ekosistemet pyjore të degraduara.	12 orë

5. Lënda “Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve” (L-25-455-17), kl 12 – 72 orë

- Synimet e lëndës “Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve”, kl . 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve ” kl ,12 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimin e shfrytëzimit ekologjik të pyjeve.
- Të përshkruajnë ndikimin e punimeve inxhinierike të ndërtimit të rrugëve auto, teleferikëve, ngrehinave, të shesheve të depozitimit në mjedisin pyjor (sedimentimi në rrjedhjet ujore, erozioni tokës, rrëshqitjet, prishja e korridoreve ekologjike të faunës së egër, etj.);

- Të përshkruajnë ndikimin në tërësi të procesit teknologjik të shfrytëzimit të ngastrave dhe sipas operacioneve të shfrytëzimit të lëndës drusore në mjedisin pyjor
- Të përshkruajnë disa nga mekanizmat kryesore të shfrytëzimit të pyllit me pak ndikime në mjedis (traktor me goma, motoargano, teleferikët, lugjet plastike);
- Të përshkruajnë masat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të njerëzve, mjeteve dhe mekanizmave; masat për mbrojtjen nga zjarret në të gjitha fazat e procesit teknologjik dhe transportit të largët të materialit drusor

• **Përmbajtja e përgjithshme e lëndës “Shfrytëzimi ekologjik i pyjeve”, kl 12-72 orë**

Tema 1	Objekti dhe qëllimi i shfrytëzimit pyjor si një proces që nuk ndikon në periudhë afatgjatë në ekosistemin pyjor.	6 orë
Tema 2	Punimeve inxhinierike të ndërtimit të rrugëve auto, teleferikëve, ngrehinave, të shesheve të depozitimit, ndikimi i tyre në mjedisin pyjor	7 orë
Tema 3	Ndikimi i operacioneve të shfrytëzimit të lëndës drusore në mjedisin pyjor (dëmtimi filizërisë, dëmtimi i tokës dhe rrjedhjeve ujore, infektimi nga speciet e dëmshme	7 orë
Tema 4	Transporti i brendshëm i materialit drusor, ndikimet e operacioneve për nxjerrjen e materialeve drusore në mjedisin pyjor (ulja e vlerës së lëndës drusore, dëmtimi i tokës, rrjedhjeve ujore).	10 orë
Tema 5	Masat zbutëse gjatë asortimit, transportit të brendshëm me krahë, mjete të thjeshta dhe mekanizma; vendet e depozitimit dhe sheshet e ngarkimit të materialit drusor;	12 orë
Tema 6	Mënyrat e ruajtjes së materialit drusor në pikat tranzite të materialit drusor; ripërtëritja dhe masat për pyllëzime.	6 orë
Tema 7	Masat e sigurimit teknik, organizimi dhe kontrolli i zbatimit të masave dhe rregullave; të mbrojtjes në punë të njerëzve, mjeteve dhe mekanizmave;	8 orë
Tema 8	Masat për mbrojtjen nga zjarret në të gjitha fazat e procesit teknologjik dhe transportit të largët të materialit drusor;	10 orë
Tema 9	Mënyrat e bashkëpunim me banorët e autoritetet vendor, për zbatimin e masave të përcaktuara pas shfrytëzimeve të cdo ngastrave.	6 orë

6. Lënda “Mbarështim pyjesh dhe kullotë pyjore” (L-25-456-17). Kl. 12 -72 orë dhe Kl.13 – 32 orë.

• **Synimet e lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotë pyjore”, kl. 12 - 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotë pyjore” kl 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë parimet bazë të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave;
- Të përshkruajnë parimet kryesore për organizimin e territorit në ekonominë pyjore, kullosore, në ngastra dhe nën/ngastra;
- Të përshkruajnë kushtet stacionale dhe grumbullin pyjor;
- Të shpjegojnë shenjat kufitare që përdoren në ndarjen territoriale, në ekonominë pyjore, kullosore, në ngastra dhe nën/nënngastra;
- Të shpjegojnë shenjat kufitare që përdoren në ndarjen territoriale në hartë;
- Të përshkruajnë rëndësinë dhe vlerën e kullotave natyrore, llojshmërinë e florës dhe

- vlerat ushqyese të barit ë kullotave;
- Të listojnë llojet e bimëve një dhe shumë vjeçare të kullotave;
- Të klasifikojnë kullotat sipas kohës së përdorimit dhe përbërjes së bimësisë;
- Të përshkruajnë masat për rritjen e prodhimit të kullotave;
- Të përshkruajnë praktikatat tradicionale të mbrojtjes e përdorimit të pyllit dhe kullotës nga familjet apo dhe në nivel fshati;
- Të përshkruajnë rëndësinë e pjesëmarrjes së komunitetit vendor në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për pyjet dhe kullotat

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullotë pyjore”, kl 12- 72 orë**

Tema 1	Parimet bazë të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave. Mbarështimi i zonave të mbrojtura.	7 orë
Tema 2	Faktorët ekologjik dhe rëndësia e tyre në mbarështimin e pyjeve me funksion prodhues dhe pyjeve me shume funksione	9 orë
Tema 3	Organizimi i territorit dhe shenjat treguese që materializojnë ekonomite pyjore/kullimore; ngastrat dhe nënngastrat.	7 orë
Tema 4	Përmbajtja e planeve të mbarështimit të pyjeve me funksione prodhuese dhe atyre shumëfunksional.	5 orë
Tema 5	Rritja e grumbujve pyjor, mundësia e shfrytëzimit në pyjet të lartë dhe në shkurre;	3 orë
Tema 6	Regjimet kryesore të pyjeve; trungjishteve; cungjishteve dhe shkurret.	10 orë
Tema 7	Mbarështimi i shëlgjishteve natyrore, masat mbrojtëse për ripërtëritjen e tyre.	7 orë
Tema 8	Masat mbrojtëse nga zjarret dhe sëmundjet si element të rëndësishëm në mbarështimin e pyjeve.	12 orë

• **Synimet e lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullote pyjore” kl. 13 - 32 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullote pyjore” kl 13, nxënësit duhet.

- Të përshkruajnë llojet e hartave në punimet e mbarështimit.
- Të dallojnë shenjat kufitare që përdoren në terren dhe në hartë
- Të përshkruajnë kriteret e ndarjes në parcela dhe nën/parcela
- Të nxjerrin të dhëna nga plani i mbarështimit
- Të përshkruajnë livadhet nga kullotat
- Të listojnë emrat e bimëve të këqija dhe helmuese
- Të dallojnë llojet e bimëve njëvjeçare, shumëvjeçare
- Të klasifikojnë kullotat sipas kohës së përdorimit
- Të klasifikojnë kullotat sipas bimësisë barishtore
- Të përshkruajnë rrugët e rritjes së efektivitetit të kullotave
- Të listojnë rregullat dhe kohën e shtegëtimit të kafshëve

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbarështim pyjesh dhe kullote pyjore”, kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Përshkrimi i kushteve natyrore të prodhimit	5 orë
Tema 2	Metodat e matjes së grumbujve pyjorë	3 orë
Tema 3	Teknika e mbarështimit të pyjeve	4 orë
Tema 4	Plane të mbarështimit të pyjeve	5 orë
Tema 5	Kullotat dhe livadhet.	3 orë
Tema 6	Bimësia e kullotave	5 orë
Tema 7	Klasifikimi i kullotave	2 orë
Tema 8	Rruget për rritjen e efektivitetit të kullotave	3 orë
Tema 9	Shfrytëzimi i kullotave	2 orë

7. Lënda “Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës pyjore” (L-25-457-17), kl. 13 - 64 orë

- **Synimet e lëndës “Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës pyjore” kl. 13 - 64 orë**

Në përfundim të lëndës “Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës pyjore”, kl.13 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë pyjet e thjeshta e të përziera.
- Të shpjegojnë zgjedhjen e llojeve në bazë të tipit të pyllit ekzistues, studimit të ambientit dhe eksperimentit.
- Të përshkruajnë llojet e drurëve që mund të përdoren në vendin tonë
- Të shpjegojnë skemat e pyllëzimeve artificiale
- Të shpjegojnë mënyrat e pyllëzimeve
- Të përshkruajnë mënyrat e mbjelljes së fidanëve
- Të përshkruajnë mirëmbajtjen e kulturave
- Të shpjegojnë pyllëzimet në ranishtet bregdetare
- Të përshkruajnë pyllëzimet në tokat e rrëshqitshme
- Të përshkruajnë brezat mbrojtës
- Të përshkruajnë mbjelljet anës rrugëve
- Të shpjegojnë mbjelljet në zonat e gjelbra
- Të shpjegojnë kultivimin e halorëve
- Të përshkruajnë shërbimet në kulturat fletore

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Pyllëzimi dhe mbrojtja e tokës pyjore”, kl 13 - 64 orë**

Tema 1	Njohuritë e përgjithshme për pyllëzimet artificiale	2 orë
Tema 2	Zgjedhja e llojeve	6 orë
Tema 3	Teknikat e pyllëzimit	8 orë
Tema 4	Pyllëzimi me farë	3 orë
Tema 5	Pyllëzimi me fidanë e kalema	6 orë
Tema 6	Mirëmbajtja e tokës dhe kulturave	3 orë
Tema 7	Pyllëzime në toka të pyllëzuara	4 orë
Tema 8	Pyllëzime në ranishtet bregdetare	3 orë
Tema 9	Pyllëzime në toka të rrëshqitshme	3 orë

Tema 10	Brezat mbrojtës	4 orë
Tema 11	Mbjelljet në rrugë	3 orë
Tema 12	Zonat e gjelbra	3 orë
Tema 13	Kultivimi i haloreve kryesorë	8 orë
Tema 14	Kultivimi i drurëve fletorë	8 orë

8. Lënda “Mbrojtje natyre dhe planifikim territori“, (L-25-234-11), kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës ”Mbrojtje natyre dhe planifikim territori”, kl. 13**

Në përfundim të trajtimit të lëndës ”Mbrojtje natyre dhe planifikim territori”, kl. 13 nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë qëllimin dhe objektivat e mbrojtjes së natyrës
- Të shpjegojnë format e ndryshme të përdorimit të tokës.
- Të shpjegojnë masat për mbrojtjen e faunës dhe bimëve të kërcënuara;
- Të shpjegojnë rëndësinë e planifikimit dhe përdorimit të territorit pa cënuar vlerat e peizazhit natyror;
- Të përshkruajnë faktorët abiotike që ndikojnë në jetën e mjedisit pyjor;
- Të përshkruajnë masat parandaluese për zjarret në mjedisin pyjor;
- Të përshkruajnë fazat e zhvillimit të zjarrit;
- Të përshkruajnë masat për shuarjen e tyre me mjete rrethanore dhe vegla dore;
- Të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në shfaqjen e zjarreve në pyje e kullota;
- Të përshkruajnë masat pas zjarrit, vlerësimi i dëmit dhe mundësia për ripërtëritje;
- Të dallojnë ngastrat më të ekspozuara për prerje të paligjshme dhe dëmtime nga faktorët atmosferike në zonë;
- Të dallojnë zonat që rrezikohen të dëmtohen nga kullotja, shtigjet dhe rrugët e lëvizjes e blegtorisë në mjedisin ku ndalohet kullotja;
- Të përshkruajnë veprimet që kryen në rastin e një kundërvajtjeje në pyll/kullotë dhe në rastin kur është kryer dëmtimi;
- Të përshkruajnë mënyrën e plotësimit, në vendngjarje të dokumentacionin të kërkuar në rast e konstatimit të dëmit;
- Të listojnë fazat e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të vrojtimit sinjalizimit për zjarret në pyje dhe kullota;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mbrojtje natyre dhe planifikim territori”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Objekti, rëndësia e mbrojtjes së mjedisit gjatë planifikimit të territorit.	3 orë
Tema 2	Mbrojtja e natyrës e përdorimi i tokës.	3 orë
Tema 3	Mbrojtja e faunës dhe bimëve të kërcënuara	3 orë
Tema 4	Mënyrat e përdorimit të territorit pa cënuar vlerat e peizazhit natyror;	4 orë
Tema 5	Faktorët abiotikë që ndikojnë në jetën e mjedisit pyjor	3 orë
Tema 6	Masat parandaluese për zjarret në mjedisin pyjor	3 orë
Tema 7	Fazat e zhvillimit të zjarrit, masat për shuarjen e tyre	4 orë
Tema 8	Masat për shuarjen e tyre me mjete rrethanore, vegla dore dhe fikset individuale.	3 orë

Tema 9	Masat pas zjarrit, vlerësimi i dëmit dhe mundësia për ripërtëritje. Fazat e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të vrojtim- sinjalizimit	3 orë
Tema 10	Dokumentacioni që plotësohet, në vendngjarje të dëmtimit të pyllit dhe kullotës.	3 orë

9. Lënda “Energjia dhe mjedisi pyjor” (L-25-458-17), kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Energjia dhe mjedisi pyjor”, kl. 13**

Në përfundim të lëndës “Energjia dhe mjedisi pyjor”, kl. 13 nxënësit duhet :

- Të përshkruajnë format e energjisë;
- Të shpjegojnë rolin e pyllit si burim biomase dhe energjie të rinovueshme;
- Të përshkruajnë rolin e pyllit në reduktimin e gazeve serë;
- Të përshkruajnë ndikimin e formave të ndryshme të energjisë në ndryshimet klimatike;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Energjia dhe mjedisi”, kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Rëndësia e energjisë. Pylli sekuestrues i mire i karbonit të drurit si burim energjie	4 orë
Tema 2	Format e energjisë. Ngastrat pyjore që klasifikohen	6 orë
Tema 3	Energjia e rinovueshme (diellore, biomasa pyjore, bujqësore, era, gjeotermike)	9 orë
Tema 4	Roli i mjedisit pyjor në sigurimin e energjisë dhe reduktimin e gazeve serë.	7 orë
Tema 5	Impaktet e formave të energjisë në mjedis	6 orë

10. Lënda ”Ligjshmëri mbi mjedisin” (L-25-236-11), kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës ” Ligjshmëri mbi mjedisin ”, kl. 13**

Në përfundim të lëndës “Ligjshmëria mbi mjedisin”, kl. 13 nxënësit duhet:

- Të listojnë dispozitat ligjore mbi trajtimin e pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore dhe faunës;
- Të përshkruajnë legjislacionin mbi ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit;
- Të përshkruajnë legjislacionin mbi peshkimin, akuakulturën dhe ushtrimin e gjuetisë;
- Të përshkruajnë dokumentacionin e veprimtarisë kontrolluese të inspektoriatit pyjor;
- Të listojnë konventat kryesore ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Të përshkruajnë legjislacionin e punës dhe kodin e etikës në punë;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ligjshmëri mbi mjedisin”, kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Pyjet dhe shërbimi pyjor, dispozitat e përgjithshme	7 orë
Tema 2	Fondi pyjor, kullotat dhe livadhet	6 orë
Tema 3	Kuadri ligjor, mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit	5 orë

Tema 4	Konventat nderkombetare ne mbrojtje te natyres dhe biodiversitetit	6 orë
Tema 5	Dokumentacioni dhe procedurat e veprimtarise kontrolluese të strukturave pyjore	4 orë
Tema 6	Legjislacioni i punes dhe kodi i etikes ne pune	4 ore

11. Lënda "Ekosistemi pyjor" (L-25-459-17), kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës "Ekosistemi pyjor", kl. 13**

Në përfundim të lëndës "Ekosistemi pyjor", kl. 13 nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë e cikleve biogjeokimike në jetesën e organizmave në mjedisin pyjor;
- Të shpjegojnë rrjedhën e energjisë dhe lëndëve ushqyese në mjedisin pyjor;
- Të përshkruajnë ndërveprimet e organizmave në shoqërimet brenda mjedisit pyjor;
- Të shpjegojnë sesi kryhet vetërregullimi në një ekosistem pyjor;
- Të shpjegojnë proceset e përzgjedhjes natyrore dhe përshtatjes në një mjedis pyjor;
- Të përshkruajnë diversitetin e specieve në një popullatë pyjore;
- Të identifikojnë faktorët që ndikojnë në rritjen e përbërësve të mjedisit pyjor;
- Të shpjegojnë normat limit në kapacitetin mbajtës të një ekosistemi pyjor dhe kullosor;

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Ekosistemi pyjor", kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Koncepti për ekosistemin (specia, popullata pyjore, shoqërimet bimore, ekosistemi, habitati, nisha dhe ekotoni, faktorët kufizues)	8 orë
Tema 2	Struktura dhe komponentët e ekosistemit pyjor	8 orë
Tema 3	Rrjedhia e energjisë në ekosistemin pyjor (ciklet biogjeokimike në një mjedis pyjor (cikli karbonit, azotit, fosforit, ujit)	8 orë
Tema 4	Zinxhirët ushqimorë (nivelet trofike, piramida ekologjike, konkurenca, simbioza	8 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punime me instrumenta topografik”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME ME INSTRUMENTA TOPOGRAFIK	M-25-1376-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në përdorimin e instrumentave topografik (gps, busull, vertex; eklimeter, metersherit etj.) në përcaktim të pikave, distancave dhe sipërfaqeve në pyje dhe kullota.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përcakton pikat e nevojshme në hartë dhe i materializon ato në terren sipas koordinatave.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgimi i zonës që kërkohet .– Përcaktimi në harte i pikave të duhura dhe gjetja në terren e tyre duke përdoruar GPS– Përpilimi i skicës së zonës.– Zgjedhja e mjeteve matëse dhe të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë identifikimit të pikave <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të vëzhgojë zonën që i nevojitet.– të përcaktojë vendin e pikave në terren sipas kordinatave të hartës– të përpilojë skicat e zonës dhe të vendndodhjes.– të përcaktojë grupin e punës që do rilevojë.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë përcaktimit të pikave të poligonit	

RM 2 Nxënësi mat pjerrësinë e terrenit dhe distancat midis pikave

Përmbajtja:

- Matja e pjerrësive dhe distancave të pjerrëta në terren.
- Orientimi në terren dhe përcaktimi i këndeve me busull

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë pjerresi dhe distanca te ndryshme me eklimeter vertex apo metersherit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së brinjëve dhe këndeve.

RM 3 Nxënësi kryen punime dhe matje në çdo pikë qëndrimi në matje të sipërfaqeve prove për qëllime të ndryshme.

Përmbajtja:

- Caktimi i grupit të punës
- Përcaktimi i detyrave të anëtarëve të grupit.
- Matja e lartësisë për çdo pikë qëndrimi
- Orientimi i instrumentit matës.
- Marrja e pikave me detaje .
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të caktojë grupin e punës.
- të kryejë veprimet e nevojshme sipas udhëzimeve në një pike të caktuar.
- të orientohet me instrumentin matës.
- të matë pikat me detaje.
- të kryejë lexime në GPS, Verteks, Eklimeter, etj.
- të kontrollojë punimet për çdo pikë qëndrimi.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve dhe matjeve në pika qëndrimi.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore. Synohet që të përdoren instrumenta e kohës për të përcaktuar kordinatat e pikave sipërfaqet kur ka demtime dhe zjarre ne pyje.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të matjeve të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore GPS, vetex, busull, metershetrit, etj, të demonstrojë plotësimin e tabelave të nevojshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore, përcaktimin e sipërfaqeve pyjore për matje .

-
- Nxënësit duhet të angazohen në marrje të dhenash të ndryshme në pikat e nevojshme në rastet e inventarizimeve të pyjeve dhe rievimeve floristike..
 - Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e matjeve në terren dhe rezultatet eqe dalin nga punimet në zyrë.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor.
 - Mjete matëse GPS, Vertx, Busull, Meter shirit.
 - Komplete veshje e puntorit në fushën e pyjeve..
 - Hipsometer, diametër matës, latë, zhalon .
 - Tabela të gatshme për hedhjen e të dhënave të grumbulluara nga matjet.
 - Harta tografike apo imazhe satelitare të objektit.
 - Makinë llogaritëse, kanceleri të ndryshme si flete vizatimi, leter kalk etj
-

2. Moduli “Trajtimi i pyjeve fletore dhe halorë”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I PYJEVE FLETORË DHE HALORË	M-25-1377-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të trajtuar teknikisht pyjet fletore dhe halorë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi trajton pyjet e ahut.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e mjeteve që nevojiten për teknikën e zbatimit të prerjeve.– Llogaritja e intensitetit të rradhimeve në pyjet e ahut.– Krijimi i biogrupeve me elementët përbërës.– Shënimi i drurëve që do të hiqen.– Zbatimi i rradhimit nga lart.(rradhim i tipit I-rë).– Vlerësimi i materialit drusor të dalë nga prerja.– Nxjerrja e materialit drusor dhe pastrimi i sipërfaqes së prerjes.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë mjetet e punës që nevojiten gjatë zbatimit të trajtimeve në pyje.– të llogaritë intensitetin e ndërhyrjes duke marrë sipërfaqe provë.– të krijojë biogrupet dhe të përcaktojë drurët e së ardhmes.– të shënojë drurët që do të hiqen me prerjet rralluese.– të zbatojë metodën e rrallimit nga lart në drurët e klasave të para dhe të dyta të rritjes.– të vlerësojë materialin drusorë të dalë nga prerja sipas dimensioneve që ato kanë.	

-
- të nxjerrë materialin drusorë jashtë parcelës
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të ahu

RM2 Nxënësi trajton pyjet e pishës së zezë.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i formës së qeverisjes së pyllit.(trungjishte)
- Përcaktimi i trajtimit që do të zbatohet(prerje të njëpasnjëshme)
- Shënimi i drurëve që do të hiqen gjatë prerjeve farore(drurët më të hollë dhe më të trashë).
- Llogaritja e intensitetit të prerjeve farore(40-60%).
- Zbatimi i prerjeve farore.
- Punimi i sipërfaqes së tokës dhe heqja e barit për të ndihmuar ripërtëritjen natyrore të pyllit.
- Zbatimi i prerjes përfundimtare.
- Pastrimi i parcelës.
- Shërbimet në filizërinë e re
- Zbatimi i prerjeve kulture(pastrime e rrallime)
- Vlerësimi i materjalit drusorë të prerë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të pishës së zezë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë formën e qeverisjes së pyllit.
- të përcaktojë llojin e trajtimit që do të zbatohet.
- të shënojë drurët që do të hiqen gjatë prerjeve farore.
- të llogarisë intensitetin e këtyre prerjeve.
- të zbatojë prerjet farore.
- të punojë sipërfaqen e tokës dhe pastrojnë barnat për të ndihmuar ripërtëritjen natyrore.
- të zbatojë prerjet përfundimtare.
- të pastrojë parcelën.
- të kryejë shërbime në filizërinë e re.
- të zbatojë prerjet kulture(pastrime e rrallime).
- të vlerësojë materjalin drusorë të prerë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të trajtimit të pishës zezë.

RM3 Nxënësi trajton pyjet e bredhit.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i trajtimit që do të zbatohet në pyjet e bredhit.
 - Përzgjedhja e veglave të punës.
 - Llogaritja e intensitetit të prerjeve farore.
 - Zbatimi i prerjeve farore.
 - Zbatimi i prerjeve përfundimtare
-

-
- Plotësime të sipërfaqeve boshe me ripërtëritje artificiale.
 - Shërbime në filizërinë e bredhit.
 - Zbatimi i rradhimeve nga poshte.(imshtajë e re)
 - Zbatimi i rrallimeve nga lart(imshtajë e mocme,trungjishte e re)
 - Vlerësimi i materialit drusorë në asortimente.
 - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve të bredhit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë trajtimin që do të zbatohet.
- të përzgjedhë veglat e punës.
- të llogarisë intensitetin e prerjeve farore.
- të zbatojë prerjet farore.
- të zbatojë prerjet përfundimtare.
- të plotësojë sipërfaqet boshe me ripërtëritje artificiale.
- të kryejë shërbime në filizërinë e bredhit.
- të zbatojë rrallimet nga poshtë.
- të zbatojë rrallimet nga lart.
- të vlerësojnë materialin drusorë në asortimente.
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zbatimit të trajtimit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në një zonë pyjore
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer trajtime në pyjet fletorë dhe halorë
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e pyjeve fletorë dhe halorë fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e këtyre proceseve, si dhe të llogaritjeve të intensiteteve të prerjeve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer trajtime në pyje.
 - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
 - Katalogë dhe manuale.
-

3. Moduli “Mbrojtje e tokës nga gërryerjet”

Drejtimi: Pyje

Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor

Niveli: III

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MBROJTJE E TOKES NGA GERRYERJET.	M-25-1378-17
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune për mbrojtjen e tokës nga gërryerjet me punime biologjike dhe ndërtimin e veprave hidroteknike	
Kohëzgjatja e modulit	72 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton drena të ndryshëm. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i vendit për ndërtimin e drenave– Përgatitja e mjeteve të punës– Përcaktimi i materialit që do përdoret– Grumbullimi i materialit– Përgatitja e vendit të punës– Ndërtimi i drenave <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë vendin për ndërtimin e drenave– të përgatisë mjetet e punës– të përcaktojë materialet që do përdoren– të grumbullojë materialet– të përgatitë vendin e punës– të ndërtojë drena <p>RM 2 Nxënësit ndërton gradona dhe mure mbajtëse Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i vendit ku do ndërtohen mure mbajtës– Përcaktimi i vendit ku do ndërtohen gradonat– Përcaktimi i llojit të gradonave– Përzgjedhja e materialit që do përdoret– Ndërtimi i murit mbajtës (mur i thatë)– Ndërtimi i gradonave	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin ku do ndërtohen muret mbajtës
- të përcaktojë vendin ku do ndërtohen gradonat
- të përcaktojë llojet e gradonave
- të përzgjedhë materialet që do përdoren
- të ndërtojë muret mbajtës (mur i thatë)
- të ndërtojë gradona

RM 3 Nxënësi ndërton vepra tërthore prej shtresash me thupra, fashina , gardhe teke cifte dhe pragje prej druri

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendit ku do ndërtohen veprat tërthore
- Përcaktimi i llojit të veprës që do ndërtohet
- Përcaktimi i llojit të fashinave
- Përzgjedhja e veglave të punës
- Përzgjedhja e materialit për veprat tërthore me fashina.
- Ndertimi i gardheve tek dhe çift, zgjedhja e llojeve dhe teknika e punimit.
- Përzgjedhja e materialit për pragjet prej druri
- Përgatitja e vendit të punës
- Ndërtimi i pragjeve prej druri
- Ndërtimi i veprave tërthore me fashina ose thupra

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin ku do ndërtohen veprat tërthore
- të përcaktojë llojet e veprave që do ndërtohen
- të përcaktojë llojet e fashinave
- të përzgjedhi veglat e punës
- të përzgjedhë materialet veprat tërthore me fashina
- të përzgjedhi materialet për pragjet prej druri
- të përgatisi vendin e punës
- të ndërtojë pragje prej druri
- të ndërtojë vepra tërthore me fashina ose thupra

RM 4 Nxënësi cakton vendin për ndërtimin e pritave me mure të thatë dhe kryen piketimin e pritës .

Përmbajtja:

- Përcaktimi i vendit ku do ndërtohet prita
- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për piketimin e pritës
- Përzgjedhja e materialit për ndërtimin e pritave
- Përcaktimi i kushteve gjeoteknike, topografike, konstrukteve, ekonomike

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë vendin ku do ndërtohet prita
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për piketimin e pritës
- të përzgjedhë materialet për ndërtimin e pritave
- të përcaktojë kushtet gjeoteknike , topografike , konstruktive, ekonomike

RM 5 Nxënësi bën punime biologjike për forcimin e brigjeve të kanaleve dhe përrenjve.

Përmbajtja:

- Përcatimi i punimeve biologjike për përforcimin e brigjeve të kanaleve dhe përrenjve
- Përzgjedhja e farave të barit
- Përzgjedhja e vendit ku do nxirren plisat e dheut me bar
- Përzgjedhja e veglave të punës
- Përzgjedhja e farave të barit
- Vendosja e plisave në brigje

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë punimet biologjike për përforcimin e brigjeve të kanaleve dhe përrenjve
- të përzgjedhë farat e barit
- të përzgjedhë vendin ku do nxirren plisat e dheut me bar
- të përzgjedhë veglat e punës
- të përzgjedhë farat e barit
- të vendosë plisa në brigje

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete.
- Nxënësit duhet të angazhohen me veprimtari konkrete pune. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset e punës, materialet e ndryshme dhe veglat si më poshtë:

- Kazma, lopata, tezga, motosegë, gërshërë, sopatë.
- Manuale udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtuam në modul

4. Moduli “Punime në mbarështimin e pyjeve dhe kullotave”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË MBARESHTIMIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE	M-25-1379-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet në mbareshtimin e pyjeve/kullotave.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndan ekonominë pyjore në ngastra dhe nën/ngastra</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Grumbullimi i bazës materiale që nevojitet për mbarështimin e pyjeve.– Kufizimi në hartë i ekonomisë pyjore.– Ndarja në hartë e ekonomisë pyjore në ngastra dhe nën/ngastra– Ndarja në terren e parcelave dhe nën/parcelave.– Verifikimi i përputhjes së ndarjes në hartë me ndarjen në terren.– Vendosja e shenjave kufitare në terren.– Numërimi dhe shënimi i parcelave në hartë– Numërimi dhe shënimi i parcelave në terren.– Respektimi i rregullave për ndarjen e ekonomisë pyjore ngastra dhe nën/ngastra– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të grumbullojë bazën materiale që nevojitet për mbreshtimin e pyjeve.– të kufizojë në hartë ekonominë pyjore.– të ndajë në hartë ekonominë pyjore në ngastra dhe nën/ngastra– të ndajë në terren ekonominë pyjore në ngastra dhe	

-
- nën/ngastra
- të verifikojë përputhjen e ndarjes në hartë me ndarjen në terren.
 - të vendosë shenjat kufitare në terren
 - të numërojë dhe të shënojë parcelat dhe nën /parcelat në hartë.
 - të numërojë dhe të shënojë parcelat dhe nën/parcelat në terren.
 - të respektojë rregullat për ndarjen e ekonomisë pyjore në parcela dhe nën/parcela.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes së ekonomisë pyjore në parcela.

**RM 2 Nxënësi përshkruan elementet te stacionin pyjor.
(Plotesimi i një skede modol në një sipërfaqe prove)**

Përmbajtja:

- Plotësimi i të dhënave identifikuese të ekonomisë.
- Përshkrimi i gjendjes aktuale të ekonomisë pyjore.
- Përcaktimi i kategorisë përdorimit të territorit(pyll, kullotë, livadh, djerrë, sipërfaqe ujore etj.)
- Përcaktimi i funksionit të pyllit duke u bazuar në kriteret përkatëse.
- Përshkrimi i konfiguracionit të terrenit.
- Përcaktimi i kundrejtimit.
- Përcaktimi i lartësisë mbi nivelin e detit.
- Përcaktimi i tipit të tokës.
- Përcaktimi i teksturës së tokës.
- Përcaktimi i Ph të tokës.
- Përcaktimi i tipit të erozionit.
- Plotësimi i skedave të përshkrimit parcelarë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të plotësojë të dhënat identifikuese të ekonomisë.
- të përshkruajë gjendjen aktuale të ekonomisë pyjore.
- të përcaktojë kategorinë e përdorimit të territorit.
- të përcaktojë funksionin e pyllit duke u bazuar në kriteret përkatëse.
- të përshkruajë konfiguracionin e terrenit.
- të përcaktojë kundrejtimin e ekonomisë.
- të përcaktoje lartësinë mbi nivelin e detit..
- të përcaktojnë tipin e tokës.
- të përcaktojnë teksturën e tokës.
- të përcaktojnë Ph-shin e tokës.
- të përcaktojnë tipin e erozionit.

- të plotësojnë skedat e përshkrimit parcelarë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përshkrimit të stacionit pyjor

RM 3 Nxënësit përshkruajnë grumbullin pyjorë.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i formës së qeverisjes mbi bazën e mënyrës së ripërtëritjes.
- Vlerësimi i fazës së zhvillimit të grumbullit pyjorë mbi bazën e karakteristikave dendrometrike..
- Përcaktimi i përbërjes së grumbullit pyjorë.
- Përcaktimi i gjendjes së vegjetacionit të grumbullit pyjorë.
- Përshkrimi i filizërisë ekzistuese në pyll.
- Përcaktimi i gjendjes së dëndësisë, lartësisë dhe moshës së filizërisë.
- Përcaktimi i llojeve të shkurreve në pyll.
- Përcaktimi i mënyrës së shpërdarjes së shkurreve.
- Përcaktimi i kurordëndësisë të grumbullit.
- Përcaktimi i origjinës të grumbullit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë formën e qeverisjes së grumbullit pyjorë mbi bazën e mënyrës së ripërtëritjes.
- të vlerësojë fazën e zhvillimit të grumbullit pyjorë mbi bazën e karakteristikave dendrometrike.
- të përcaktojë përbërjen e grumbullit pyjor.
- të përcaktojë gjendjen e vegjetacionit të grumbullit pyjorë.
- të përshkruajë filizërinë ekzistuese në pyll.
- të përshkruajë gjendjen e dëndësisë, lartësisë dhe moshën e filizërisë.
- të përcaktojë llojet e shkurreve në pyje.
- të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes së shkurreve.
- të përcaktojë kurordendësinë e grumbullit pyjorë.
- të përcaktojë origjinën e grumbullit pyjorë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përshkrimit të grumbullit pyjor

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në zonë pyjore
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer inventarizime në pyjet fletorë dhe halorë
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e pyjeve fletorë dhe halorë

fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve, si dhe të llogaritjeve të intensiteteve të prerjeve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:

- Ekonomi pyjore per te kryer trajtime në pyje.
 - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
 - Katalogë dhe manuale.
-

5. Moduli “Mbrotjtje e pyjeve dhe kullotave nga zjarret”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrotjtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	MBROJTJE E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRET	M-25-1380-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit me mënyrat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi merr masa parandaluese për mbrotjtjen nga zjarri të mjedisit pyjor/ kullosor</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Ngritja e grupit të punës dhe ndarja e detyrave të secilit pjesmarës.– Analizimi i parcelave dhe nën/parcelave, identifikimi i atyre parametrave që mundësojnë vlerësimin e rritjes së mundësise së zjarrit.– Përcaktimi dhe zbatimi i masave parandaluese si: ligjore; edukative, informative-propaganduese.– Vendosje tabelash dhe njoftime publike ne vendet qe ekspozohen nga zjarret.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrotjtjes së mjedisit gjatë lëvizjes në parcela. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të ngrejë grupin e punës për MNZ dhe ndajë detyrat.– të zbatojë ligjin, duke e bërë së pari të njohur atë; të informojë dhe komunikojë me barinjet, banorët dhe qeverisjen vendore.– të vendosë tabelat e nevojshme paralajmëruese për zjarret.– të përcaktojë pikat e vrojtimit dhe mënyrat e sinjalizimit dhe ndërlihdjes në cdo rast zjarri– të përcaktojë rrugët e lëvizjes dhe mjetet vetiake të cdo personi– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrotjtjes ne	

punë të njerezve gjatë lëvizjes në pyll dhe në rast zjarri.

RM 2 Nxënësi merr masat përgatitore për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Përmbajtja:

- Zbatimi i planit vjetor të masave të përcaktuara për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave.
- Vrojtimi dhe njoftimi për zbulimin e shpejt (në kohë) të zjarrit.
- Përcjelljen e informacioneve të sakta për vendin e zjarrit, rrugët e lëvizjes dhe përmasat dhe rreziqet e tij
- Përcaktimi i rrugëve të lëvizjes zjarrfiseve dhe mjeteve të tjera auto.
- Furnizimi me mjetet dhe pajisjet e duhura për personat që do merren me shurjen e zjarreve. Kendet e MNZ.
- Piketimi dhe ndërtimi i brezave dhe koridoreve për izolimin e zjarreve në pyje dhe zonat që i qarkojnë ato.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përgatisë planin vjetor të masave për mbrojtjen nga zjarri të pyjeve e kullotave në një ekonomi pyjore/kullosore
- të bëjë vrojtimin dhe njoftimin e shpejtë për zbulimin e zjarrit. (Vrojtim në kulla apo pika të lartësive, patrullime në mjediset pyjore, vrojtme elektronike)
- të bëjë piketimin dhe ndërtimin e brezave dhe koridoreve për izolimin e zjarreve në pyje dhe zonat që i qarkojnë ato.
- të përdorë mjetet dhe mekanizmat që ka në dispozicion.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për mbrojtjen në punë dhe të mjeteve në dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës.

RM 3 Nxënësi merr pjesë direkt në kufizimin dhe shuarjen e zjarrit.

Përmbajtja:

- Eleminimi (heqja) e njëri nga tre elementet e trekëndëshit të zjarrit (burimi i zjarrit ose materiali që po digjet ose rrymat e ajrit oksigjeni)
- Shuarja e zjarrit me dhe (metoda e dheut).
- Shuarja e zjarrit me ujë (metoda e ujit)
- Shuarja e zjarrit me zjarr (metoda e zjarrit).
- Shuarja e zjarrit me substanca kimike (metoda kimike).
- Shuarja e zjarrit me eksploziv (metoda eksplozive)
- Shuarja e zjarrit me aeroplan (hedhja e ujit nga ajri)
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë vlerësimit të masës drusore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë elementet e zjarrit dhe tek cili do të mund nderhyhet .
- të zbatojë të gjitha metodat e izolimit dhe shuarjes zjarreve si me siper, perjashto ate me eksploziv dhe avion.
- të jenë veçanërisht të vetëdijshëm për rreziqet e pranishme gjatë kalimit të terrenit në kushtet e shikimit të reduktuar, për shkak të dritës së pakët ose tymit të madh
- te jenë të vetëdijshëm për zonat e sigurisë që zbatohen për njerzit, për mjetet, pajisjet dhe makineritë që kane ne dispozicion.
- te vendosin gjithmonë sigurinë e jetës dhe kolegeve të parën ku jeni duke shuar zjarrin,të sigurohet që zjarri është shuar para se të lëvizni për në detyrën tjetër apo sigurohuni që mbikqyrësi juaj është vënë në dijeni se zjarri nuk është shuar në zonën tuaj, nëse ju është dhënë udhëzimi për të lëvizur.
- të kontrollojë veten dhe kolegët tuaj për ndonjë plagosje. pas zjarrit,
- të raportojë tek mbikëqyrësit për gjendjen pas shuarjes zjarrit, për njerezit dhe mjetet.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete duke marrë pjesë ne raste zjarresh ne pyje dhe kullota.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve parandaluese, përgatitore dhe shuarje te zjarreve ne zona te aferta pyjore/kullosore duke zbatuar te gjitha rregullat e MNZ.
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave paralameruese dhe materialeve informuese që do ju jepen

barinjeve dhe banoreve. Te beje biseda dhe takime ne komunitet per parandalimin dhe shurjen e zjarreve

- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik te njerezve, të mbrojtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor normal ku te demonstrohen masat parandaluese, nje grumbull pyjor qe eshte duke u djegur ku te mund te zbatohen metodat e shuarjes zjarit.
 - Mjete pune te ndryshme qe ju vihen ne dispozicion.
 - Komplete veshje per punet me zjarret..
-

6. Moduli “Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në fidanishtet dhe masivet pyjore”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	LUFTIMI I SËMUNDJEVE DHE DËMTUESVE NË FIDANISHTE DHE MASIVET PYJORE	M-25-1381-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të përcaktuar dhe luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit e fidanave dhe masiveve pyjorë.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi grumbullon gjethë, fidana, degë, copa druri të infektuara dhe të dëmtuar. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgimi i fidanishtes dhe masivit pyjor.– Mbledhja e materialeve vegetative të infektura.– Vlerësimi i karakterit të dëmit.– Grumbullimi i larvave.– Grumbullimi i insekteve.– Dërgimi në laborator.– Identifikimi i sëmundjes.– Përcaktimi i dëmtuesve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të vëzhgojë fidanat, druret dhe grumbujt pyjor– të grumbullojë gjethet e sëmura– të mbledhë ekxeplare nga llojet e dëmtuar– të vlerësojë karakterin e dëmit– të grumbullojë larvat– të grumbullojë insektet– të identifikojë sëmundjet– të përcaktojë dëmtuesit	

RM 2 Nxënësi merr masa parandaluese për të luftuar sëmundjet dhe dëmtuesit në fidanishte
Përmbajtja

- Mbledhja e farërave të pastra e fidanave të shëndoshtë.
- Pastrimi i tokës nga barërat e këqija.
- Punimi i tokës.
- Frezimi dhe diskimi i tokës.
- Vendosja e brezave ngjitës.
- Vendosja e drurëve kurth.
- Prerja dhe shkatërrimi i qeskave të vemjeve.
- Prerja e pjesëve të infektuara.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të mbledhë farëra të pastra
- të mbledhë fidana të shëndoshë
- të pastrojë tokën nga barërat e këqija
- të bëjë punimin e tokës
- të bëjë frezimin e tokës
- të bëjë diskimin e tokës
- të bëjë shkatërrimin e qeskave të vemjeve
- të presë pjesët e infektuara
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë marrjes së masave parandaluese ndaj sëmundjeve të fidanëve

RM 3 Nxënësi lufton sëmundjet këpurdhore e bakteriale.

Përmbajtja

- Përcaktimi i preparatit për trajtimin e sëmundjes (lëngu bordolez).
- Përgatitja e përzierjes.
- Përcaktimi i përqendrimit të preparatit.
- Verifikimi i reaksionit me letër lakmues.
- Përgatitja e veglave për spërkatje.
- Kryerja e spërkatjes.
- Përcaktimi i drureve apo degeve që do priten për të luftuar kancerin e gështenjes dhe kryerja e operacioneve të tjera deri në izolim të masës së demtuar.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e sëmundjeve në fidanishte dhe në pyje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përcaktojë fungicidin
- të përcaktojë përqendrimin në bazë të fidanit
- të përcaktojë përzierjen

- të verifikojë reaksionin me letër lakmues
- të përgatisë veglat për spërkatje
- të kryejë spërkatjen e fidanave
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. gjatë proceseve të punës për luftimin e sëmundjeve në fidanishte.

RM 4 Nxënësi lufton insektet që dëmtojnë fidanat dhe druret e rritur të veçuar apo në masiv.

Përmbajtja

- Përgatitja e ushqimeve të helmuara.
- Shpërndarja e ushqimeve të helmuara.
- Përcaktimi i preparatit për luftimin e dëmtuesit.
- Përcaktimi i tretësirës.
- Përlllogaritja e sasisë së preparatit kg/ha.
- Përgatitja e veglave për spërkatje.
- Kryerja e spërkatjes së fidanave.
- Kryerja e punimeve për të luftuar dëmtuesit kryesor të dushqeve, procesionaren e pishes, etj.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e dëmtuesve në fidanishte dhe masive pyjore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë ushqimet e helmuara
- të shpërndajë ushqimet e helmuara
- të përgatisë preparatet në forme lëngu
- të përcaktojë tretësirën
- të përlllogarisë sasinë e preparatit që duhet kg/ha
- të përgatisë mjetet që duhen për spërkatje
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për luftimin e dëmtuesve në fidanishte dhe masive pyjore

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional në fidanishte pyjore dhe masivet pyjore.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jete e mundur demonstrime konkrete për të mbrojtur fidanat në fidanishte, druret e vecuara dhe ata në masivet pyjore.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për të mbrojtur fidanat në fidanishte, në fillim në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Në pyje dhe masivet pyjore shfrytëzohen rastet kur behen nderhyrje nga subjekte të specializuara
- Ata duhet të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për të mbrojtur fidanat nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

-
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet ti vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve për të mbrojtur fidanat dhe druret e vecuar dhe ne masiv pyjor.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise te praktikës për të mbrojtur fidanat në fidanishte dhe vlerësimet e demëve në masivet pyjore. .
 - Komplet i veglave, veshjet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për të kryer sferkatje të ndryshme.
 - Preparate dhe solucione kimike për mbrojtjen e fidanave.
 - Katalogje, manuale udhëzues, etj.
-

7. Moduli “Pyllëzimet me farë dhe fidana”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PYLLEZIMET ME FARË DHE FIDANA	M-25-1382-17
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer pyllëzimet artificiale të tokave të zhveshura me farë dhe fidana.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi punon tokën. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Punimi i tokës sipas skemës, mënyrës dhe materialit mbjellës të përcaktuar në projekt.– Përcaktimi i korridoreve për shërbime dhe mbrojtje nga zjarret <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të bëjë punimin e tokës– të përcaktojë korridoret për shërbime dhe mbrojtje nga zjarret. <p>RM 2 Nxënësi bën mbjelljen e farave, fidanave, kalemave apo shpatullave. Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Analiza e skemave të pyllëzimit– Përcaktimi i rradhës së punës.– Njohja me normën e farës për gropë apo njësi sipërfaqje.– Zgjedhja e veglave të punës.– Teknika e shpërndarjes dhe mbjelljes së farës, fidanave kalemave, shpatullave, etj.– Kolaudimi i objektit të mbjellë <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të njohë për zbatim projektin e pyllëzimit për një objekt të	

- caktuar
- të përcaktojë rradhën e punës
- të përzgjedhë farën, fidanat dhe veglat e punës,
- të bëjë kolaudimin dhe marrjen e masave mbrojtëse të një objekti të pyllëzuar.

RM 3 Nxënësi bën mbjelljen e farës me rreshta.

Përmbajtja

- Analiza e skicave të mbjelljes.
- Përcaktimi i veglave të punës.
- Piketimi i vijave.
- Hapja e vijave.
- Hedhja e farës.
- Mbulimi i farës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të argumentojë skemat e mbjelljes
- të përzgjedhë veglat e punës
- të bëjë piketimin e vijave
- të hapë vijat
- të hedhë farën
- të mbulojë farën

RM 4 Nxënësi bën mbjelljen e farës në gropëza dhe të fidanave në gropa apo sheshe

Përmbajtja

- Analiza e skemave të mbjelljes.
- Përcaktimi i rradhës së punës.
- Piketimi i gropave.
- Zgjedhja e veglave.
- Hapja e gropave.
- Vendosja e farërave, fidanave kalemave dhe shpatullave.
- Punimet përfundimtare të mbjelljes.
- Rregullat e sigurisë në punë dhe ruajtja e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë skicat
- të përcaktojë rradhën e punës
- të piketojë vendin
- të përzgjedhë veglat
- të bëjë hapjen e gropave
- të kryejë vendosjen e farërave dhe fidanave
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së objektit të pyllëzuar.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise për praktikat profesionale ne parcelën pranë shkollës, në pyjet artificiale.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrimet konkrete në proceset e punës në pyjet artificiale.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për mbjelljen e farërave në pyjet e rinj në fillim të mbikqyret dhe me pas të punojë në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës në pyjet artificiale. Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të verifikohet shkalla e arritjes së shprehive praktike për realizimin e mënyrave të mbjelljes.
- Realizimi i pranueshem i modulit do të konsiderohet arritja e kenaqshme e te gjitha kriterëve te realizimit te specifikuara per cdo rezultat te te mesuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin e këtij moduli është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Parcelë per kryerjen e praktikës
 - Projekt pyllëzimi i nje objekti kompleks. Harte topografike
 - Vegla te thjeshta dore, si kazma, bel, shate, krehera etj
 - Prehra te ndryshem
 - Fara dhe fidana te ndryshme
 - Uniforma e punes
 - Kataloge, manuale te ndryshme.
-

8. Moduli “Transporti i brendshëm pyjor dhe ndikimet në mjedis”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TRANSPORTI I BRENDSHËM PYJOR DHE NDIKIMET NE MJEDIS	M-25-1383-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit të kryejnë transportin e brendshëm pyjor me mënyra të ndryshme	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”:	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen procese përgatitore për transportin me traktorë në parcela Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Analiza e parcelave dhe nënparcelave për transport– Leximi i skemës për transportin në planin e shfrytëzimit.– Përcaktimi i rrugëve të lëvizjes për nxjerrjen e materialit.– Llogaritja e leverdisë ekonomike të transportit.– Përcaktimi i llojit të transportit që do zbatohet.– Hartimi i skemës teknologjike të transportit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të analizojë parcelat dhe nënparcelat.– të lexojë skemën e transportit të zgjedhur në planin e shfrytëzimit– të përcaktojë rrugët e lëvizjes së materialit në terren.– të llogarisë leverdinë ekonomike të transportit.– të përcaktojë llojin e transportit të brëndëshë.– të hartojë skemën teknologjike të transportit.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë gjatë transportit me traktorë. <p>RM 2 Nxënësit transporton me traktorë pyjor (zinxhir) Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Zgjedhja e tipit të traktorit.	

- Përcaktimi i llojit të mekanizmave për çdo asortiment.
- Përcaktimi i skemave të shtrirjes së rrugës.
- Hapja e traseve në të cilën do të kalojë traktori.
- Përcaktimi i vëllimit të ngarkesës në varësi të pjerrësisë.
- Vendosja e pajisjeve tërheqëse në traktor.
- Realizimi i tërheqjes dhe transportimit me traktor.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë transportit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë tipin e traktorit.
- të përcaktojë llojin e mekanizmave për transport.
- të përcaktojë skemën e shtrirjes së rrugës
- të hapë trasenë në të cilën do kalojë traktori.
- të përcaktojë vëllimin e ngarkesës.
- të vendosë pajisjet tërheqëse në traktor.
- të realizojë tërheqjen dhe transportin.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë transportit.

RM 3 Nxënësi vezhgon transportin me teleferik

Përmbajtja:

- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Vendosja në punë e teleferikut.
- Dërgimi i vagonetës në pikën e ngarkimit.
- Formimi i ngarkesës për një rrugë.
- Lidhja, sinjalizimi dhe ngritja e ngarkesës.
- Ngritja e ngarkesës deri tek vagoneta.
- Tërheqja dhe lëshimi i vagonetës drejt vendit të depozitimit.
- Shkarkimi dhe depozitimi i materialit drusor.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë transportit me teleferik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë mjetet e punës për transport.
- të vendosë në punë teleferikun.
- të formojë ngarkesën për një rrugë.
- të lidhë dhe të sinjalizojë nisjen e ngarkesës.
- të ngrëjë ngarkesën deri tek vagoneta.
- të tërheqë dhe të lëshojë vagonetën drejt vendit të depozitimit.
- të shkarkojë dhe të depozitojë materialin drusor.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë transportit me teleferik

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në sheshe depozitimi afër pyjeve ku prodhohet materiali drusor.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të transportit me traktorë dhe me teleferik, si traktore me zinxhire me goma dhe zbritësa të thjeshtë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për ndërtimin e rrugëve të kalimit të traktorit dhe të teleferikëve, në mënyrën e lidhjes së materialit në mjetin e transportit në vendosjen në punë të makinerive në ndërtimin e kaminës.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe instrumenteve gjatë punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e transportit me traktorë dhe teleferikë

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Vegla dore, lopata ,kazëm,sëpatë,motosharra,sqeparë,vare.kova uji,mjete transporti, traktorë dhe zbritësa të thjeshtë.
- Mekanizma për mbajtjen e ngarkesës .
- Litarë për lidhjen e ngarkeses.
- Plane shfrytëzimi.
- Mjete dhe instrumenta matëse.etj

9. Moduli “Punime përgatitore në rrugët pyjore”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME PËRGATITORE NË RRUGËT PYJORE	M-25-838-12
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune për punimet përgatitore në rrugët pyjore.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranimit	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përcakton në terren elementët ndërtimor të rrugës. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Punime operatore të bazuara mbi të dhënat e objektit.– Rikontrolli i boshtit të rrugës së projektuar.– Plotësimi i piketave që mungojnë.– Kryerja e punimeve shtesë.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë në terren elementët ndërtimor të rrugës.– të rikontrollojë në terren boshtin e rrugës së projektuar.– të kontrollojë piketat që n.q.s mungojnë të zëvendësohen me reperi të palëvizshme (druri , gurë etj) .– të bëjë punime shtesë. <p>RM 2 Nxënësi pastron brezin e terrenit ku do të krijohet trupi i rrugës. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Zgjedhja e veglave të punës.– Punime për pastrimin e sipërfaqes natyrale në gjerësinë e brezit nga bimësia vegjetative (drurë , shkurre etj) .– Punime për pastrimin e gurëve dhe mbeturinave natyrore apo artificiale.– Shkulja e cungjeve.	

- Përgatitja e veglave të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zgjedhë veglat e punës
- të bëj pastrimin e brezit të terrenit nga bimësia vegjetative.
- të pastrojë trupin e rrugës që do të krijohet nga gurët dhe mbeturinat natyrore dhe artificiale.
- të bëj shkulljen e cungjeve.
- të përgatitë veglat e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë pastrimit të terrenit

RM 3 Nxënësi kryen profilizimin e trupit të rrugës dhe veprave të artit.

Përmbajtja:

- Punime për tharjen e zonave me lagështi të madhe.
- Vendosja e reperiave në gjatësinë e platformës, pjerrësinë e skarpatave.
- Shkriftimi i terreneve të forta dhe shumë të forta.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë punime për tharjen e zonave dhe sipërfaqeve me lagështi të madhe.
- të vendosë reperet në gjatësinë e platformës dhe pjerrësinë e skarpateve.
- të bëjë me mjete të thjeshta shkriftimin e terreneve të forta dhe shumë të forta.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete .
- Nxënësit duhet të angazhohen me veprimtari konkrete pune. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e punimeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikua për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset e punës materialet e ndryshme dhe veglat si me mëposhtme:

- Motosegë
 - Gërshërë
 - Kazma
 - Lopata
 - Sopatë
 - Karrocë dore
 - Piketa.
 - Manualet , udhëzuesa , materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtuam në modul.
-

10. Moduli “Llogaritje ekonomike për aktivitete pyjore”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	LLOGARITJE EKONOMIKE PER AKTIVITETE PYJORE	M-25-837-12
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer llogaritje ekonomike për aktivitetet pyjore	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e asortimenteve të drurit. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Llogaritjet ekonomike për prodhimin e asortimenteve të drurit.– Hartimi i preventivit për punimet në prodhimin e asortimenteve të drurit.– Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.– Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.– Kostot në punimet për prodhimin e asortimenteve të drurit.– Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj).– Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh, etj)– Detyrimet fiskale për prodhimin e asortimenteve të drurit, llogaritja e tyre.– Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit gjatë prodhimit të asortimenteve të drurit.– Përgatitja e faturës për proceset e kryera në prodhimin e asortimenteve të drurit.– Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.– Marketingu i produkteve (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit, reklamës) Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e	

-
- asortimenteve të drurit;
 - të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e asortimenteve të drurit;
 - të përcaktojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj)
 - të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj);
 - të llogaritë detyrimet fiskale në prodhimin e asortimenteve të drurit;
 - të llogaritë të ardhurat, fitimin gjatë prodhimit të asortimenteve të drurit
 - të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për prodhimin e asortimenteve të drurit
 - të përgatitë faturën për koston e produkteve
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
 - të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën.

RM 2 Nxënësit kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e këpurdhave.

Përmbajtja:

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e këpurdhave.
- Hartimi i preventivit për punimet në prodhimin e këpurdhave.
- Preventivi i materialeve, kostoja e materialeve.
- Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.
- Kostot në punimet për prodhimin e këpurdhave.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj).
- Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- Detyrimet fiskale për prodhimin e këpurdhave, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit gjatë prodhimit të këpurdhave.
- Përgatitja e faturës për proceset e prodhimit të këpurdhave.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu i produktit (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit)

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritje ekonomike për prodhimin e këpurdhës
- të përcaktojë koston në punimet për prodhimin e këpurdhës

- të përcaktojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj)
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- të llogaritë detyrimet fiskale në prodhimin e këpu dhës
- të llogaritë të ardhurat, fitimin për prodhimin e këpu dhës
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për prodhimin e këpu dhës
- të përgaritë faturën për koston e prodhimit të këpu dhës
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit.

RM 3 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore.

Përmbajtja:

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materiale.
- Preventivi i shërbimeve, kostoja për shërbime.
- Kostot në punimet për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj)
- Kosto të tjera (transporti, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- Detyrimet fiskale për prodhimin e bimëve eterovajore llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Përgatitja e faturës për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu i produktit (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i çmimit, mënyrat e shpërndarjes së produktit, reklama

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritjet ekonomike për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përcaktojë koston për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përcaktojë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj)
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj)
- të llogaritë detyrimet fiskale për prodhimin e bimëve eterovajore

- të llogaritë të ardhurat, fitimin për prodhimin e bimëve eterovajore
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtare për prodhimin e bimëve eterovajore
- të përgaritë faturën për koston e produkteve eterovajore
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të kryejë veprimtari të marketingut që lidhen me studimin e tregut të shitjes, përcaktimin e çmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në klasë, pranë drejtorive të shërbimit pyjor në rreth, si dhe në biznese privatë në fushën e pyjeve .
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të llogaritjeve ekonomike.
- o Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve praktike për llogaritje të thjeshta ekonomike të hartimit të një plan biznesi për prodhimin e asortimenteve të drurit, për prodhimin e këpurdhave, për prodhimin e bimëve eterovajore.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të plotësimit dokumentacionit të nevojshëm, ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm, analizën e këtyre dokumentacioneve dhe nxjerrjen e konkluzioneve të rëndësishëm financiar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të ndryshme për realizimn e llogaritjeve të thjeshta ekonomike përcaktimin e cmimit , të koston dhe fitimit të çdo produkti të përmendur më sipër.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Modele projektesh te aplikuar ne fushën e pyjeve.
 - Pajisje kancelarie.
 - Interneti
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e koston.
 - Përmbledhje e legjislacionit në fushën e pyjeve që lidhet me prodhimet pyjore(kodi i punës, legjislacioni fiskal).
 - Modele të dokumetacionit financiar dhe fiskal.

11. Moduli “Ruajtja dhe ekonomizimi i materialit drusor”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RUAJTJA DHE EKONOMIZIMI I MATERIALIT DRUSOR	M-25-837-12
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në ekonomizimin e ruajtjen e materialit drusor gjatë transportit dhe depozitimit.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi merr në dorëzim asortimentet drusore në sheshe depozitimi. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Përgatitja e shesheve të depozitimit ose skelave.– Matja e vëllimit të lëndës punuese në m3.– Përcaktimi i sipërfaqeve të shesheve të depozitimit.– Matja e vëllimit të druve të zjarrit në m3.– Matja e gjatësisë së trupave dhe diametri në mesin e tyre.– Shënimi i diametrit dhe gjatësisë në kokat e trupave.– Shënimi me bojë ose me gëlqere i drurëve të zjarrit.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përgatisë sheshet e depozitimit dhe skelat për të grumbulluar materialin.– të përcaktojë sipërfaqet e shesheve të depozitimit.– të llogarisë vëllimin e lëndës së punimit në m3.– të matë gjatësinë dhe diametrin në mesin e trupit.– të shënojë në kokat e trupave dhe të lëndës së ndërtimit diametrin dhe gjatësinë e tyre.– të shënojë drutë e zjarrit me bojë ose gëlqere.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për depozitimin e materialit.	

RM 2 Nxënësi mbron drurët e prerë nga dëmtuesit gjatë qëndrimit në depozitë.

Përmbajtja:

- Zgjedhja e metodave të ruajtjes dhe mbrojtjes së lëndës.
- Zbatimi i metodës së zgjedhur në varësi të asortimentit.
- Përdorimi i metodës së njomë për trupat e ahut, kompesatos dhe trupat e sharrës.
- Përdorimi i spërkatjes së trupave me ujë.
- Lyerja e trupave të porsaprerë me pasta .
- Përdorimi i mënyrës së thatë në trupat për lëndë ndërtimi shtylla telefoni etj.
- Stivimi i materialit drusor sipas kushteve të përcaktuara.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë metodat efikase për mbrojtjen e drurit.
- të zbatojë metodat e përzgjedhura me shume korrektësi në varësi të asortimentit.
- të përdorë metodën e njomë të ruajtjes së materialit.
- të përdorë metodën e thatë për lëndë ndërtimi, shtylla miniere, shtylla telefoni etj.
- të përdorë metodën e ruajtjes me spërkatje të trupave.
- të lyejë trupat e porsa prerë me pasta të ndryshme për mbrojtjen e tyre nga dëmtuesit
- të stivosë materialin sipas kushteve teknike të përcaktuara.
- të pastrojë, të mirëmbajë dhe të sistemojë mjetet e punës që ka përdorur.
- të zbatojë me korrektësi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë mbrojtjes së materialit të depozituar

RM 3 Nxënësi shfrytëzon drurin në mënyrë racionale

Përmbajtja:

- Përcaktimi i humbjeve në shfrytëzimin e pyjeve.
- Regjistrimi i humbjeve gjatë prodhimit të asortimenteve pyjore.
- Regjistrimi i humbjeve gjatë prodhimit të asortimenteve
- Regjistrimi i humbjeve gjatë transportit të brendëshëm.
- Llogaritja e vëllimit të humbjeve në cung.
- Llogaritja e vëllimit të humbjeve në drurët e hollë dhe të vegjël.
- Llogaritja e humbjeve nga heqja e lëvores.
- Përcaktimi i humbjeve për lëndën e punimit.
- Përcaktimi i humbjeve për drutë e zjarrit.

- Zgjedhja e mjeteve për shfrytëzimin sa më racional të pyllit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë shfrytëzimit racional të pyllit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë humbjet gjatë prodhimit të asortimenteve.
- të regjistrojë humbjet e transportit të brendshëm.
- të regjistrojë humbjet gjatë manipulimit.
- të përdorë vëllimin e humbjeve në trung.
- të përdorë humbjet në drurin e hollë dhe të vogël.
- të kontrollojë humbjet nga lëvorja.
- të përcaktojë humbjet e lëndës së punimit.
- të përcaktojë humbjet për drutë e zjarrit.
- të përzgjedhë mjetet e domosdoshme për një shfrytëzim sa më racional .
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në shfrytëzimit pyjor

RM 4 Nxënësi merr masa për ekonomizimin e drurit.

Përmbajtja:

- Përdorimi i masave silvikulturore.
- Përdorimi me efikasitet i masave të shfrytëzimit.
- Sigurimi i dokumentacionit teknik për fondin e shfrytëzimit
- Vlerësimi i plotë i grumbujve pyjorë të dëmtuar.
- Ulja e konsumit të përdorimit të drurit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë ekonomizimit të drurit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë masat silvikulturore .
- të përdorë me efikasitet masat e shfrytëzimit të pyllit
- të sigurojë fondin teknik të shfrytëzimit.
- të vlerësojë grumbullin pyjor të dëmtuar.
- të ulë konsumin e materialit drusor pa kriter.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë ekonomizimit të drurit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në parcelat dhe nën parcelat pyjore.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të depozitimit në sheshe dhe skela depozitimi të materialit të shfrytëzuar në të

gjithë asortimentet.

- Instruktori duhet të realizojë praktikisht ruajtjen dhe mbrojtjen e drurit nga dëmtimet me metodën e njomë, të thatë etj.
- Instruktori duhet të realizojë praktikisht format dhe menyrat e ekonomizimit të drurit dhe përcaktimin e llojeve të ndryshme të humjeve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në llogaritje konkrete të humjeve në asortimenteve të ndryshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në matjen e diametrave dhe të lartësive të drurit për përcaktimin e vëllimit të materialit drusor.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për ekonomizimin e drurit dhe uljen e konsumit të materialit drusor.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedis pune shfrytëzimi.
 - Mjetet, instrumentet matëse diametri dhe lartësie të drurit..
 - Komplet i veshjes së punëtorit.
 - Skela të gatshme për transportimin e drurit..
 - Sheshe depozitimi në parcela ose nën/parcela.
 - Dokumentacion teknik për fondin pyjor.
 - Rezervuar uji për mbrojtjen e drurit,
 - Spërkatës për spërkatjen e drurit.
 - Pasta për lyerjen e druëve në kokat e tyre.
 - Pankarta për punimet e ndryshme gjatë depozitimit dhe menyrave të depozitimit.
 - Skica të gatshme për mbrojtjen e drurit.
 - Pajisje kancelarie.
 - Makina llogaritëse dore.
 - Manualet e preventivimit dhe për zbërthimin e kostos.
-

12. Moduli: “Përmirësimi e mbrojtja e bimeve mjekesore natyrore”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PERMIRESIMI E MBROJTJA E BIMEVE MJEKESORE NATYRORE	M-25-1385-17
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer shërbime në bimët mjekesore tanifere natyrore	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi bën punime në terren që favorizojnë zhvillimin e bimëve mjekesore natyrore. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Heqja e gurëve, prerja e grumbullimi i bimëve të dëmshme në sipërfaqet me bimë mjekesore.– Bërja e mureve (pragje guri) për ndalim gërryrjeve të tokës dhe rreth bimëve– Ruajtja e bimëve për ripërtëritje dhe prodhim të farërave.– Mbrojtje nga dëmtimet dhe zjarret <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të mbledhë gurët dhe bimët e padobishme që pengojnë zhvillimin e bimëve mjekesore– të ruajë ekzemplaret natyrore të bimëve– të përzgjedhë dhe të kujdeset për bimët farore– të përgatisë terrenin për grumbullim të bimëve (herbe, lule, fara dhe fruta)– të organizojë mbrojtjen dhe vjeljen e produkteve sipas teknikave të përcaktuara <p>RM 2 Nxënësi bën punime përmirësuese dhe ripërtëritëse në sipërfaqet me bimë. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Punim pjesor i tokës rreth bimeve i shoqëruar me mure guri– Krastitje ripërtëritëse të bimeve për prodhim mase për	

- grumbullim dhe si ekzemplare për prodhim fare
- Krastitje e bimëve të përzgjedhura për prodhim fare
- Pleherime të mundeshme organike dhe kimike
- Punime të siperfaqeve boshe, dendesim me fare dhe kalema sipas llojit të bimës
- Rrethime me mjete rrethimore për të ndaluar kullotjen dhe hyrjet e pakontrolluara në objekt.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë punimet e nevojshme
- të realizojë krastitjet prodhuese për masë dhe prodhim fare
- të kryejë pleherime të mundeshme organike dhe kimike
- të bëjë punimet për dendesim të bimëve në siperfaqet e mundeshme.
- të kryejë rrethime me mjete rrethimore për të ndaluar kullotjen dhe hyrjet e pakontrolluara në objekt

RM 3 Nxënësi kryen vjeljen e bimeve (herbe, lule e gjethe; fruta dhe fare; degeza e levore, etj).

Përmbajtja

- Kalendar i vjeljes bimeve, koha dhe pjesa që vilet
- Mjetet dhe pajisjet për vjelje të produkteve.
- Rregullat teknike në vjelje dhe mjetet që përdoren për cdo lloj bime.
- Transporti nga ngastra në rugët auto
- Transporti në qendrat e përpunimit dhe masat për ruajtje
- Shërbimet në sheshet e depozitimit tharje dhe manipulim paraprak
- Përgatitje e produktit si lëndë e parë i gatshëm për përpunim dhe ambalazhim
- Përpunimi i disa llojeve kryesore për eksport, (sherebela, timus, trumeza, disa fruta dhe lule te zones).
- Ambalazhimi, etiketimi i produkteve kryesore
- Mbrojtja nga zjarret në plantacionin e bimeve dhe në sheshet e grumbullimit dhe përpunimit
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në punë dhe ruajtjes së mjedisit nga ndotjet

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të bëjë grumbullimin dhe përpunimin e bimëve sipas kërkesave biologjike dhe teknike në kohe optimale.
- të bëjë sipas llojit vjeljen pa dëmtuar bimën, por duke siguruar ripërtritje të saj dhe prodhim të vijshëm
- të bëjë punimet e nevojshme për tharje dhe manipulim të bimeve në sheshet dhe pikat e përpunimit.

- të përdorë mjetet e nevojshme për fikje të zjarrit ne terren dhe në pikat e grumbullimit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale në parcelat me bimë mjekësore që zhvillohen në gjendje natyrore..
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë demonstrime konkrete të proceseve të punës për permiresim dhe vjelje të bimëve mjekësore. Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për shtim, grumbullim dhe përpunim të bimëve mjekësore e tanifere., fillimisht në mënyrë të mbikëqyrtur nga instruktori apo punonjësi me përvojë dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me proceset e ndryshme të punës. Gjate vlerësimit të nxënësve bëhet verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në permiresim, vjelje dhe përpunim të bimëve mjekësore
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kësajshme e kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Parcele me bimë mjekësore natyrore për kryerjen e praktikës
 - Vegla të thjeshta dore, si kazma, bel, shate, gershere dore, kosore, etj
 - Thasë për transport
 - Pleh organik, dherishte
 - Preparatë për disinfektim
 - Uniformat e punës
 - Manuale teknike të bimëve mjekësore, Katalogje, Liber standartesh, etj.
-

13. Moduli “Inventarizimi dhe mbrojtja e faunës”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INVENTARIZIMI DHE MBROJTJA E FAUNES”	M-25-1386-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në njohjen e karakteristikave të faunës objekt gjuetie dhe mbarështimi i qëndrueshëm i tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e kl.12 të profilit mësimor “Mbrojtje e mjedisit pyjor”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen vrojtme në sipërfaqet pyjore. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgimi i terrenit (rikonjucioni)– Zgjedhja e hartës orientuese.– Përcaktimi i rradhës së punës .– Ndërtimi i grupeve të punës.– Përcaktimi i vendodhjes së kafshëve dhe shpendëve .– Përgatitja e mjeteve të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të vëzhgojë terrenin .– të zgjedhë hartën orientuese– të përcaktojë rradhën e punës në terren– të ndajë grupet e punës sipas detyrave .– të përcaktojë vendodhjen e kafshëve dhe shpendëve kryesore objekt gjuetie dhe me status te vecante.– të përgatisë mjetet e punës .– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vrojtmeve në sipërfaqet pyjore <p>RM 2 Nxënësi inventarizon shpendët dhe kafshët në zonat pyjore Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i zonës së inventarizimit .– Zbatimi i metodikes dhe udhëzimeve për	

- inventarizimin e popullatave të kafsheve dhe shpendeve të egra në pyje dhe kullota.
- Specifikimi i llojeve (shpendëve dhe kafshëve) nëpërmjet pamjes së jashtme.
- Përpilimi i tabelave të inventarizimit për sipërfaqet provë sipas modelit të miratuar.
- Përlllogaritja me tabela për popullatat kryesore të efektivave për gjithë zonën dhe një vlerësim i përgjithshëm i gjendjes së tyre shendetesore.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë zonën e inventarizimit.
- të zgjedhë hartën orientuese të zonës pyjore.
- të zgjedhë sipërfaqet provë.
- të specifikojë llojet nëpërmjet personave (teknikë dhe gjuetarë)
- të verifikojë dokumentacionin për llojet.
- të përpilojë tabelat e inventarizimit për sipërfaqe provë.
- të llogarisë për gjithë zonën të gjithë sasinë e gjahut.
- të përgatisë hartën me simbole për kafshë shpendë të zonës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ato të mbrojtjes së mjedisit gjatë inventarizimit të shpendëve

RM 3 Nxënësi përcakton kafshët dhe shpendët që rrezikohen apo janë në zhdukje

Përmbajtja:

- Përcaktimi i zonës ku do ndalohet ushtrimi i gjuetisë në mënyrë strikte ose zonat e ripopullimit.
- Zgjedhja e mënyrave të ruajtjes dhe të shtimit të faunës.
- Vendosja e tabelave lajmëruese për zonën ku do të ndalohet gjuetia.
- Përgatitja e materialeve informative dhe ndergjegjesuese për banoret vendor.
- Vendosja e ushqimoreve të ndryshme në pyll, përcaktimi i llojeve dhe sasia e ushqimeve që mund të shpërndahet në një zonë të caktuar .
- Evidentimi i kafshëve dhe shpendëve të dëmshme për zonën dhe faunen e dabishtme. Përcaktimi i mënyres dhe mjeteve për largimin e tyre.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit të zonave të ripopullimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të pëcaktosh zonën e shtimit të kafshëve dhe të shpendëve. –Zona e Ripopullimit
- të zgjedhësh mënyrat më të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kafshëve dhe shpendëve.
- të vendosësh tabelat lajmëruese për zonën se ku ndalohet gjuetia duke lajmëruar popullsinë vendore dhe autoritetet përgjegjëse..
- të informosh dhe të bashkëpunosh me komunitetet vendore për mbrojtjen dhe zhvillimin e faunes
- të zbatosh rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë gjuajtjes me çifte

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në zona pyjore ose në zonat e mbrojtura të nileve të ndryshme mbrojtje.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve të inventarizimit dhe mbrojtjes faunes, hartimin e tabelave dhe të hartës së faunes me simbolet përkatëse..
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore ndarjen e zonave të inventarizimit ,zgedhen e sipërfaqeve provës specifikimin e llojeve ,verifikimin e grumbullimit të dhënave në drejtorite e shërbimit pyjor por edhe nga popullsia e zonës dhe nga gjuetarët,
- Nxënësit duhet të angazhohen në përgatitjen e tabelave të inventarizimit dhe përcaktimin e llojeve dominuese të zonës dhe të ndërtojë hartën me përfaqësuesit kryesorë të kafshëve dhe shpendëve të zonës.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe paisjeve..
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimin e inventarizimit të gjatut , të formave dhe mënyrave të ruajtjes dhe zhvillimit për llojet kryesore të kafshëve dhe shpendëve të zonës

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- Sipërfaqe pyjore ose grumbull pyjor.
 - Mjete pune të ndryshme, dylbi, GPS,
 - Komplete veshje e punës së pylltarit
 - Pankarta për njoftime të ndryshme .
 - Kanceleri për mbajtjen e shënimeve
 - Tabela të gatshme për të hedhur të dhënat e grumbulluara .
 - Dokumente të D.SH. Pyjor mbi të dhënat e zonës. .
 - Hartë dhe busull orjentuese në terren.
 - Manuale për njohjen dhe mbareshtimin e kafshëve dhe shpendëve të egra që rriten në pyje dhe kullota.
-

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Trajtimi i pyllit për qëllime të posaçme”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI I PYLLIT PËR QËLLIME TE POSAÇME	M-25-659-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të trajtuar pyllin për qëllime mbrojtje.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi trajton pyllin për mbrojtjen e tokës nga gërryerja. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përcaktimi i formës së qeverisjes në pyllin me funksion mbrojtës (trungjishte e përzier me shume kate)– Prerja e drurëve me të zgjedhur (trajtimi kopshtorë).– Zbatimi i variantit (prerje) me breza të këmbyer në cungjishte dhe në shkurre.– Përcaktimi i gjerësisë së brezit.– Përcaktimi i drejtimit të brezit.– Vlerësimi i materialit drusore të prerë.– Pastrimi i pyllit nga mbeturinat.– Rregullimi i përzierjes së llojeve në përbërje (mbjellje e llojeve fletorë)– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë formën e qeverisjes të pyllit me funksion mbrojtjen e tokës nga gërryerja.– të zbatojë trajtimin kopshtorë në trungjishte.– të zbatojë variantin me breza të këmbyer në cungjishte.	

-
- të përcaktojë gjatësinë dhe gjerësinë e brezit.
 - të përcaktojë drejtimin e brezit.
 - të vlerësojë materialin drusorë të prerë.
 - të pastrojë pyllin nga mbeturinat.
 - të rregullojë përzierjen e llojeve me mbjellje të llojeve fletorë.
 - të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi trajton zonat e gjelbërta.

Përmbajtja:

- Heqja e drurëve të padëshiruar në zonat e gjelbërta (të dëmtuar, të sëmurë, të tharë, që paraqesin rrezik për njerezit, etj).
- Krasitja artificiale e degëve të kurorave.
- Mbjellja e llojeve dekorativë në këto zona.
- Mbjellja e shkurreve dekorative.
- Krasitja e kurorave të shkurreve duke i dhënë forma të ndryshme.
- Mbjellja e luleve që formojnë mozaik ngjyrash.
- Mirëmbajtja e territoreve për dëfrime (pista sporti, kende lojrash, etj.)
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të heqë drurët e padëshiruar në zonat e gjelbërta.
- të krasitë degët e kurorave.
- të mbjellë lloje dekorative në këto zona.
- të mbjellë shkurre dekorative.
- të krasitë kurorat e shkurreve duke i dhënë forma të ndryshme.
- të mbjellë lule që formojnë mozaik ngjyrash.
- të mirëmbajnë territoret që shërbejnë për dëfrime
- të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

RM 3 Nxënësit trajtojnë pyjet parqe (pyje ekzistues natyrorë).

Përmbajtja:

- Zbatimi i prerjeve kopshtore për të mbajtur të përherëshëm vegjetacionin në pyje.
- Zbatim i prerjeve sanitare në pyje parqe.
- Pastrimi i pyllit nga ferrat e mbeturinat.
- Mbjellje e llojeve të ndryshëm pyjorë për të rregulluar përbërjen e pyllit.
- Mirëmbajtja e livadheve me pastrime.

- Mbjellje bari në sipërfaqe boshe(livadhe)
- Mbjellje shkurresh si mjet strehimi dhe ushqimi për faunën e pyllit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së territorit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë prerjet kopshtore për të mbajtur të përhershëm vegjetacionin në pyje.
- të zbatojë prerjet sanitare në pyjet parqe.
- të pastrojë pyllin nga ferrat dhe mbeturinat.
- të mbjellë lloje të ndryshëm pyjorë për të rregulluar përbërjen e pyllit.
- të mirëmbajë livadhet me pastrime.
- të mbjellë barë në sipërfaqe boshe(livadhe).
- të mbjellë shkurre si mjet strehimidhe ushqimi për faunën e pyllit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit të pyjeve në parqe

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikën profesionale në pyjet me funksione të posaçme.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer trajtimet në pyjet për qëllime të posaçme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në pyjet për qëllime të posaçme fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve për qëllime të posaçme, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer trajtimin e pyjeve.
 - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
 - Katalogë, manuale, plane mbarështimi, udhëzues për mbarështimin e pyjeve urban..
-

2. Moduli “Shërbime për përmirësimin dhe mbrojtjen e kullotave”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME PER PERMIRESIMIN DHE MBROJTJEN E KULLOTAVE	M-25-1387-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer shërbime dhe punime për mbrojtje dhe përmirësime të kullotave.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi bën përmirësimin sipërfaqësor të kullotave. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Pastrimi i gurëve në sipërfaqe.– Pastrimi i gurëve gjysëm të futur në tokë.– Transportimi i gurëve.– Vendosja e gurëve në pragje në perroskat e krijuara– Krijimi i brezareve me mure të thata.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përmirësimit sipërfaqësor të kullotave <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të pastrojë gurët në sipërfaqe– të pastrojë gurët gjysëm të futur në tokë– të transportojë gurët– të vendosë gurët në pragje të vegjël për të ndaluar gërryerjen.– të krijojë brezare me mure të thata– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përmirësimit sipërfaqësor të kullotave. <p>RM 2 Nxënësi pastron kullotat nga shkurret e bimët e tjera të dëmshme. <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Identifikimi i shkurreve dhe bimëve të tjera të dëmshme në kullotë– Pastrimi me shkulje	

- Pastrimi me plug
- Pastrimi me djegie
- Pastrimi me mjete kimike
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në kullotë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të identifikojë shkurret e dëmshme dhe bimët helmuese
- të pastrojë me shkulje
- të kryjë punime pastrimi me plug
- të pastrojë me djegie
- të pastrojë me mjete kimike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë pastrimit të kullotave

RM 3 Nxënësi mirëmban dhe mbron kullotat

Përmbajtja

- Plehrimi me plehra azotike
- Plehrimi me plehra fosforike
- Plehrimi me plehra organike
- Kullimi i ujit të tepërt
- Rulimi i barit
- Sigurimi i numrit të bimëve
- Kontroll i erozionit dhe mbikullotjes
- Masat kunder zjarreve
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në kullotë

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të plehrojë kullotat me plehra azotikë
- të plehrojë kullotat me plehra fosforikë
- të plehrojë kullotat me plehra organikë
- të kryejë kullimin e ujit të tepërt
- të rulojë barin
- të sigurojë numrin e bimëve
- të parandalojë gerryerjet dhe zjarret.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në kullotë

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në kullota e livadhe.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jete e mundur demonstrime konkrete për shërbimet e punime në

kullota.

- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për të punuar shërbyer në kullota e livadhe, në fillim në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për të marrë prodhime të mira në kullota e livadhe.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes të shprehive praktike për realizimin e proceseve në shërbime dhe punime në kullota.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mesuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës për të kryer procese pune në kullota e livadhe.
 - Komplet i veglave, veshjet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për të kryer shërbime të ndryshme.
 - Plehra kimike, organike, kosa, draper, makina korrese, vende për manipulimin e barit.
 - Katalogje, manuale udhezues etj.
-

3. Moduli “Punime në inventarizimin e pyjeve”

Drejtimi: Pyje
Profili: Mbrojtje e mjedisit pyjor
Niveli: III
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË INVENTARIZIMIN E PYJEVE	M-25-1388-17
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punimet në inventarizimin e pyjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Pyje”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndan ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parceta.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Grumbullimi i bazës materiale që nevojitet për inventarizimin e pyjeve.– Kufizimi në hartë i ekonomisë pyjore.– Ndarja në hartë e ekonomisë pyjore në parcela dhe nën/parceta.– Ndarja në terren e parcelave dhe nën/parcelave.– Verifikimi i përputhjes së ndarjes në hartë me ndarjen në terren.– Vendosja e shenjave kufitare në terren.– Numërimi dhe shënimi i parcelave në hartë– Numërimi dhe shënimi i parcelave në terren.– Respektimi i rregullave për ndarjen e ekonomisë pyjore në parcela dhe nën /parceta.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të grumbullojë bazën materiale që nevojitet për inventarizimin e pyjeve.– të kufizojë në hartë ekonominë pyjore.– të ndajë në hartë ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parceta.– të ndajë në terren ekonominë pyjore në parcela dhe nën/parceta.	

-
- të verifikojë përputhjen e ndarjes në hartë me ndarjen në terren.
 - të vendosë shenjat kufitare në terren
 - të numërojë dhe të shënojë parcelat dhe nën /parcelat në hartë.
 - të numërojë dhe të shënojnë parcelat dhe nën/parcelat në terren.
 - të respektojë rregullat për ndarjen e ekonomisë pyjore në parcela dhe nën/parcela.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë ndarjes së ekonomisë pyjore në parcela.

RM 2 Nxënësi përshkruan stacionin pyjor.

Përmbajtja:

- Plotësimi i të dhënave identifikuese të ekonomisë.
- Përshkrimi i gjendjes aktuale të ekonomisë pyjore.
- Përcaktimi i kategorisë përdorimit të territorit (pyll, kullotë, livadh, djerrë, sipërfaqe ujore etj.)
- Përcaktimi i funksionit të pyllit duke u bazuar në kriteret përkatëse.
- Përshkrimi i konfiguracionit të terrenit.
- Përcaktimi i kundrejtimit.
- Përcaktimi i lartësisë mbi nivelin e detit.
- Përcaktimi i tipit të tokës.
- Përcaktimi i teksturës së tokës.
- Përcaktimi i Ph të tokës.
- Përcaktimi i tipit të erozionit.
- Plotësimi i skedave të përshkrimit parcelarë.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të plotësojë të dhënat identifikuese të ekonomisë.
- të përshkruajë gjendjen aktuale të ekonomisë pyjore.
- të përcaktojë kategorinë e përdorimit të territorit.
- të përcaktojë funksionin e pyllit duke u bazuar në kriteret përkatëse.
- të përshkruajë konfiguracionin e terrenit.
- të përcaktojë kundrejtimin e ekonomisë.
- të përcaktojë lartësinë mbi nivelin e detit..
- të përcaktojë tipin e tokës.
- të përcaktojë teksturën e tokës.
- të përcaktojë Ph-shin e tokës.
- të përcaktojë tipin e erozionit.
- të plotësojnë skedat e përshkrimit parcelarë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së

mjedisit gjatë përshkrimit të stacionit pyjor

RM 3 Nxënësit përshkruajnë grumbullin pyjorë.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i formës së qeverisjes mbi bazën e mënyrës së ripërtëritjes.
- Vlerësimi i fazës së zhvillimit të grumbullit pyjorë mbi bazën e karakteristikave dendrometrike..
- Përcaktimi i përbërjes së grumbullit pyjorë.
- Përcaktimi i gjendjes së vegjetacionit të grumbullit pyjorë.
- Përshkrimi i filizërisë ekzistuese në pyll.
- Përcaktimi i gjendjes së dëndësisë, lartësisë dhe moshës së filizërisë.
- Përcaktimi i llojeve të shkurreve në pyll.
- Përcaktimi i mënyrës së shpërdarjes së shkurreve.
- Përcaktimi i kurordëndësisë të grumbullit.
- Përcaktimi i origjinës të grumbullit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë formën e qeverisjes së grumbullit pyjorë mbi bazën e mënyrës së ripërtëritjes.
- të vlerësojë fazën e zhvillimit të grumbullit pyjorë mbi bazën e karakteristikave dendrometrike.
- të përcaktojë përbërjen e grumbullit pyjor.
- të përcaktojë gjendjen e vegjetacionit të grumbullit pyjorë.
- të përshkruajë filizërinë ekzistuese në pyll.
- të përshkruajë gjendjen e dëndësisë, lartësisë dhe moshën e filizërisë.
- të përcaktojë llojet e shkurreve në pyje.
- të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes së shkurreve.
- të përcaktojë kurordendësinë e grumbullit pyjorë.
- të përcaktojë origjinën e grumbullit pyjorë.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përshkrimit të grumbullit pyjor

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesionalë në zonë pyjore
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete për të kryer inventarizime në pyjet fletorë dhe halorë
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për të kryer procese pune në trajtimet e pyjeve fletorë dhe halorë fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e

-
- rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve të punës dhe instrumenteve matëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës në trajtimin e pyjeve, të përdorimit të mjeteve të punës për realizimn e këtyre proceseve, si dhe të llogaritjeve të intensiteteve të prerjeve.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Ekonomi pyjore për të kryer trajtime në pyje.
 - Komplete veglash dhe veshjesh për të punuar në mjediset pyjore.
 - Katalogë dhe manuale.
-